UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
FAKULTETI I MJEKËSISE
DEPARTAMENTI I SËMUNDJEVE INFEKTIVE
DHE DERMATOLOGJISË

PËR MARRJEN E GRADËS SHKENCORE
"DOKTOR"

TEMA

Studim epidemiologjik dhe klinik I vitiligos ne rrethin e Tiranes.

KANDIDATI
ARDIANA SINANI

UDHËHEQËS SHKENCOR
PROF. DR. ENVER ROSHI

TIRANË, 2020
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË

FAKULTETI I MJEKËSISË
DEPARTAMENTI I SËMUNDJEVE INFEKTIVE
DHE DERMATOLOGJISË

I

PARAQITUR NGA

ARDIANA SINANI

PËR MARRJEN E GRADËS SHKENCORE

"DOKTOR"

SPECIALITETI: DERMATOLOGJI

TEMA

Studim epidemiologjik dhe klinik I vitiligos ne rrethin e Tiranes.

Udhëheqës Shkencor: PROF. DR. ENVER ROSHI

MBROHET ME DATË...../...../2020 PARA JURISË

1. **Prof Ermira Vasili KRYETAR**
2. **Prof Arjan Harxhi OPONENT**
3. **Prof. As Loreta Kuneshka OPONENT**
4. **Prof Najada Como ANËTAR**
5. **Prof As Alban Ylli ANËTAR**

PERMBAJTJA

PARATHENIE ..... **Error! Bookmark not defined.**
MIRENJOHJE ..... **Error! Bookmark not defined.**
LISTA E SHKURTIMEVE ..... **Error! Bookmark not defined.**
PERSE ZGJODHA KETE TEME DOKTURATURE ..... **Error! Bookmark not defined.**
1-HYRJE ..... **Error! Bookmark not defined.**
1.1 HISTORIA E PATOLOGJISE SE VITILIGOS ..... **Error! Bookmark not defined.**
1.2 PERKUFIZIMI DHE LLOJET E VITILIGOS ..... **Error! Bookmark not defined.**11
1.3 PREVALENCA E VITILIGOS DHE PARAQITJA KLINIKE ..... **Error! Bookmark not defined.**
1.4 ETIOLOGJIA DHE PATOGJENEZA E VITILIGOS ..... **Error! Bookmark not defined.**
2.QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E STUDIMIT 54
2.1 QELLIMI I STUDIMIT 54
2.2 OBJEKTIVAT SPECIFIKE TE STUDIMIT 55
3.METODOLOGJIA 55
3.1 PËRZGJEDHJA E SUBJEKTEVE NË STUDIM 55
3.2 MBLEDHJA E TË DHËNAVE 57
3.4 ANALIZA STATISTIKORE E TË DHËNAVE 60
4.REZULTATET E STUDIMIT 61
5. DISKUTIMI 62
5.1 PERMBLEDHJA E REZULTATEVE TE STUDIMIT 62
5.2 KRAHASIMI I REZULTATEVE ME RAPORTIMET E LITERATURES 62
6. PERFUNDIME 63
7 REKOMANDIME 64
6.BIBLIOGRAFIA .....

PARATHENIE.

Shëndeti sipas OBSH përkufizohet si gjendje e mirëqënies së plotë fizike, mëndore dhe sociale. Në kuadër të përkufizimit të sipërpërmendur Vitiligo është një sëmundje që paraqet interes, pasi ajo shfaq ndikim përveçse në sferën fizike, edhe në atë emocionale.

Nga studimet botërore rezulton se prevalenca e vitiligos është 1-2%. Megjithatë të dhënat për Shqipërinë mungojnë. Kjo është një arsye për realizimin e një studimi në mënyrë që të njihet shkalla e përhapjes së ketij problemi në Shqipëri.

Gjithashtu duke patur parasysh ndikimin që lekura ushtron në sferën emocionale të individit të prekur nga kjo sëmundje si dhe referuar faktit që ajo është një sëmundje përgjithesisht e panjohur për shoqërinë shqiptare, lind nevoja e realizimit të një studimi i cili do të përcaktojë faktorët që ndikojnë në cilësinë e jetës së subjekteve të prekur nga Vitiligo, në mënyrë që të bëhet i mundur identifikimi i atyre faktorëve që e përkeqësojnë cilësinë e jetës si dhe të propozohen ndërhyrjet e mundshme.

MIRENJOHJE

Shpreh mirënjohjen time stafit të shërbimit të dermatologjisë në Spitalin ushtarak. Shërbimit të Dermatologjisë, Qëndra Spitalore Nënë Tereza, Departamentit të Sëmundjeve Infektive, Dermatologjisë , Qëndra Spitalore Nënë Tereza. ,

Jam mirënjohëse udhëheqësit tim shkencor Prof. Dr. Enver Roshit, për mbështetjen , inkurajimin dhe suportin përgjatë kohës së studimit tim.

Falenderoj Dekanatin e Fakultetit te Mjekësisë që më besoi dhe më lejoi të zhvilloja këtë temë doktorature.

Dedikuar mamase time qe aq shume deshironte qe une te isha mjeke.

LISTA E SHKURTIMEVE

BB-UVB - Broad Band Ultra Violet light B

BSA - Body surface area

CDLQI – Children Dermatology Life Quality Index

DLQI – Dermatology Life Quality Index

MED – Minimal Erythema Dose

MET – Maximum Exposure Time

NB-UVB - Narrow Band Ultra-Violet light

NSV – non-segmental vitiligo

RCT - Randomised controlled trial

SCORAD – Severity Scoring for Atopic Dermatitis

SV – Segmental vitiligo

TCS – Topical Corticosteroids

UV – Ultra Violet light

UVA - Ultra Violet light A

UVB - Ultra Violet light B

VASI – Vitiligo Areas Scoring Index

VIDA – Vitiligo Disease Activity Score

VETF - Vitiligo European Task Force

Perse kam zgjedhur për të ndërmarrë këtë teme studimi?

Gjatë studimeve të mia në shkollën mjekësore kam kuptuar se praktika klinike duhet të shoqërohet me parimet e mjekësisë .

Hyrja në dermatologji më bëri me te perkushtuar ne në këtë fushë. Gjatë trajnimit tim si specializante dhe me vone gjate praktikes sime mjekesore si dermatologe, kuptova se aftësia për të diagnostikuar sëmundjet e lëkurës, kënaqësia e vendosjes sakte te diagnoses dermatologjike , hetimi dhe trajtimi, mjekesor apo kirurgjikal dhe egzaminimi histopatologjike me beri te kuptoj se sa marrëdhënie komplekse ka në mes të lëkurës dhe të organeve të brendshme.

Që atëherë unë kam kërkuar në mënyrë aktive çdo mundësi qe me përfshin në aktivitetet e dermatologjise akademike për të kontribuar dhe për të përmirësuar praktikat aktuale klinike.

Sherbimi I Dermatologjise ne Qendren Spitalore Universitare “Nene Tereza” dhe ne Spitalin Ushtarak (vendi ku une aktualisht punoj), njihen si qendra me përsosmëri dhe një reputacion kombëtar për diagnostikimin dhe trajtimin e semundjeve te lëkurës, kjo fale punes dhe perpjekjeve te brezave me radhe te dermatologeve qe kane punuar me perkushtim ne keto qendra. Unë besoj se projekti im I doktoratures " Epidemiologjia dhe klinika e Vitiligos", në Dermatologji do të jetë vendimtar dhe i frytshëm për progresin tim arsimor dhe zhvillimin e karrierës time profesionale dhe nje ndihmese për të përfshirë rezultatet e mia klinike kërkimore në praktikë klinike dermatologjike.

-Pse zgjodha nje teme studimi mbi vitiligon?

Sëmundjet e lëkurës janë shumë të zakonshme, ato prekin më shumë se një te katërten e e popullsisë në bote. Edhe pse zakonisht nuk jane te rrezikshme për jetën, sëmundjet e lëkurës kane një ndikim të rëndësishëm në cilësin e jetës së pacientëve dhe të shkaktojne ndryshime të konsiderueshme psikologjike.

Studimi im i propozuar nga Sherbimi I Dermatologjise QSUT fokusohet mbi vitiligon, nje semundje që rezulton në humbjen e pigmentit ne lëkure nje patologji me një ndikim mjaft negativ në cilësinë e jetes se një pacienti me vitiligo, dhe per shkak te mungeses se te dhenave mbi epidemiologjine dhe format klinike te kesaj patologjie ne Shqiperi dhe gjithashtu mungeses se te dhenave statistikore mbi vitiligon ne Shqiperi ne Statistikat mjekesore te vendeve ne bote per vitiligon.

Keshtu pra, lindi kjo nevojë për një studim me të gjerë mbi kete semundje sepse duke u bazuar ne epidemiologjine e saj dhe format klinike na ndihmojne per gjetur nje mënyre me efektive per trajtimin dhe kurimin e kesaj patologjie.

Kapitulli I pare e ketij studimi I dedikohet shqyrtimit te literatures. Ka nje informacion të kufizuar në dispozicion mbi vitiligon dhe për këtë arsye kapitulli im i parë është një (up-to-date) vështrim I literatures mbi kete sëmundje, duke përfshirë përkufizim, klasifikimi,

etiologjine, histopatologjine, prognozën, vlerësimi dhe trajtimin. Duke bërë këtë, jam përpjekur të përmbledhë dëshmi, hipotezat dhe sugjerimet ekzistuese, dhe gjithashtu për të identifikuar disa nga mangësitë kërkimore dhe aspekte të ndryshme te studimeve mbi kete semundje.

Vitiligo është një çrregullim fituar depigmentimit te lekures që prek rreth 0,5% -2%[7, 8] te popullsisë botërore. Megjithatë shifra te larta si 8% janë raportuar në Indi, ku për shkak të ngjyrës se errët të lëkurës Vitiligo është më dukshme dhe perben shqetesim te madh kozmetik ne kete popullate. [9, 10.]

Si shoqëritë e lashta dhe ato moderne gjithmon kane perceptuar hypopigmentimin e lekures (njollat e bardha) në një mënyrë negative. Vitiligo ndikon ne mirëqënien sociale dhe psikologjike të pacientit dhe në jetën shoqërore te tij. Pacientët shpesh përjetojnë stigmatizem, duke përfshirë edhe kureshtje, nga njerëzit e tjerë, refuzimin dhe diskriminimin në punë, vetëvlerësim të ulët, siklet, dhe një prevalencë më të lartë të vështirësive seksuale, sidomos tek gratë. Natyra e sëmundjes kronike, trajtimi afatgjatë, mungesa e terapisë uniforme efektive dhe sigurisht dekursi i paparashikuar janë zakonisht demoralizuese për pacientët që vuajnë nga vitiligo.

1-Hyrje

1.1 Historia e Vitiligos

Celsus ishte i pari qe ka përdorur emrin e vitiligos në shkrimet e tij latine mjekesore ne "De Medicina" në shekullin e dytë para Krishtit[78,69] . Besohet se emri vitiligo rrjedh nga fjala latine "vitium" we do të thotë defekt ose një të metë[71,62,69] . Sëmundja (Vitiligo), e cila "shkakton njolla te bardha".

Qe në kohët e lashta, ka te dhena per vitiligon, keto te dhena jane gjetur janë gjetur në librat e lashtë të shenjta indiane, të tilla si Atharva Veda (1400BC) dhe ne librin e shenjtë budist Vinay Pitak (224-544 BC)[69] (Picardo et al., 2010).

Foto 1.1 Foto e shekullit 18 (Vitiligo Faciale).

Në Bibël, Dhiata e Vjetër, jane permendur pesë kategoritë e sëmundjeve që shkaktojnë njolla të bardha te cilat jane: (1) njolla të bardha në vetvete, (2) njolla të bardha të lidhur me flokët te cila kthehen te bardhë, (3) njolla të bardha të lidhurme inflamacion, (4) njolla te bardha me deskuamim dhe (5) njolla të bardha (spote) me atrofi. Dy kategoritë e para mendohet të jene referuar vitiligos. Që prej kohëve te lashta, meshkujt dhe femrat me njollat e bardha të lëkurës, nuk janë respektuar në shoqëri, ata diskriminoheshin nuk martoheshin ose nuk ju lejohej te martoheshin, ose në qoftë se njollat e bardha ndodhnin gjatë martesës, kjo ishte nje arsye e forte per divorc[69,55].

Vitiligo eshte perkufizuar si një, çrregullim kronik I fituar I depigmentimit te lëkurës, qe shkaktuar nga humbja e pigmentit në zonat e prekura të lëkurës dhe / ose mukozave dhe

karakterizohet nga macula (njolla) me ngjyre qumështi të bardhë, jo te deskuamuara me kufij te qarte me lekuren e shendoshe. Qimet në lëkurën me vitiligo fillimisht mbeten te pigmentuara dhe me pas ato fillojne te depigmentohen dhe shfaqet, leucotrichia (flokë ne ngjyra te bardhe) . Rrallë mund te preket edhe ngjyra e syve . Vitiligo qe nganjëherë referohet si leucoderma (-leu · bashkë · · der ma) nga fjalët greke "LEUCO" do të thotë e bardhë, dhe "Derma" që do të thotë lëkurë, karakterizohet nga lezione te depigmentura në lëkurë që rezultojne nga humbja apo dëmtimi i melanocyteve [69](Picardo et al, 2010).

1.2 Përkufizimi dhe llojet e vitiligo.

-Përkufizimi i vitiligos.

Ne ditet e sotme akoma ka mungesë aktuale te konsensusit në përcaktimin dhe metodat e vlerësimit të këtij çrregullimi, që e bën vitiligon te vështirë për të krahasuar rezultatet e studimeve të ndryshme të bera mbi kete patologji.

Në vitin 2007, Vitiligo Europian Task Force (VEFT) botoi një letër konsensusi i cili propozonte përkufizimin konsensual dhe klasifikimin e Vitiligos si me poshte.

Vitiligo vulgaris / vitiligo Jo-segmental (NSV) është çrregullim I fituar kronik depigmentues qe karakterizohet nga njolla të bardha, shpesh simetrike, te cilat zakonisht rriten në madhësi me kalimin e kohes, e cila shoqerohet me një humbje të konsiderueshme të funksionit epidermik dhe nganjëherë humbje te ngjyres (depigmentim) te flokeve [80] .

Vitiligo segmentale (VS) përkufizohet si depigmentim (njolla te bardha qe jane te shpërndara ne menyre te njëanshme dhe që mund të përputhen tërësisht ose pjesërisht por jo domosdoshmërisht me një dermatome, [80] .

Dermatome është përcaktuar si një zonë e lëkurës që inervohet nga një nerv i vetem, me origjinë nga një rrënjë e vetme qe del nga shtylla kurrizore .

Vitiligo Mixe është e karakterizuar nga prania e dy lezioneve, vitiligo jo-segmentale dhe vitiligo segmentale ne te njejtin pacient.

Tabela 1.1 Llojet e vitiligos [80](Taieb and Picardo, 2007)

Llojet e vitiligos	Nen llojet e vitiligos

Vitiligo Jo-segmentale	Focal, mucosal, acrofacial, generalised, universal
Vitiligo Segmentale	Focal, mucosal, unisegmental, bi or plurisegmental
Mixe (vitiligo jo-segmentale dhe vitiligo segmentale	Focal, mucosal, acrofacial, unisegmental, bi ose Plurisegmentale generalised, universal
E pa klasifikuar	Focal në fillim, multifokale, asimetrike jo segmental, mukozale (një vend)

Aktualisht terma të tjera te ndryshem janë përdorur gjithashtu në literature për të përshkruar klinikisht vitiligon të tilla si: 1-Vitiligo Fokale, 2- vitiligo acrofaciale, 3- vitiligo e gjeneralizuar 4- vitiligo universale dhe 5- vitiligo mukosale.

Figura 1.2.2.1 

Vitiligo mund të zhvillohet dhe progresoje me kalimin e kohës, dhe klinikisht patologjia mund te kaloje nga një lloj ne llojin tjeter te vitiligos duke qene active dhe rralle here duke bere regres (permisuar)[49].

Nëntipe klinike të vitiligo

-Vitiligo fokale karakterizohet nga nje ose disa macula (njolla) te bardha te lokalizuara jo sipas shpendarjes te dermatomale[69] .

Foto 1.2. Vitiligo fokale.

-Vitiligo Acrofaciale prek zonat periorificial te fytyrës dhe lekuren ne gjymtyrët distal. Vitiligo ne zonat periorificial prek lëkurën rreth syve, hundes, vesheve, gojes ,[69] (Picardo et al., 2010)

Foto 1.3 Vitiligo acrofaciale

- Vitiligo mukosale prek mukozen e gojë ose / dhe mukozat gjenitale dhe futet tek vitiligo jo-segmentale ose mund te jete pjese e vitiligos fokale [69](Picardo et al., 2010).

Foto 1.4 Vitiligo mukozale

Vitiligo e gjeneralizuar futet ne llojin e vitiligos jo segmentale[69] (Picardo et al., 2010).

Foto 1.5 vitiligo e gjeneralizuar

- Vitiligo Universalis karakterizohet nga depigmentimi I plote ose pothuajse i plotë I lekures I shoqeruar me vatra te vogle te pigmentuara ne zonat e lekures te ekspozuara nga dielli. Kjo është forma më e rëndë e vitiligos jo-segmentale[69] (Picardo et al., 2010).

Foto 1.6 - Vitiligo Universale.

- Trichrome ose multichrome vitiligo shihet ne shumicen e rasteve tek personat me lekure te erret ku brenda nje pllake vitiligoje ka zona te depigmentuara totalisht dhe zona me hypopigmentim si dhe zona me ngjyre normale te lekures[69]. (Picardo et al., 2010).

Foto 1.7 - Vitiligo Multichrome.

- Vitiligo inflamatore i referohet lezioneve te bardha me buze rreth e qark erythematoze ku mund te bashkeshoqerohet me prurit te lehte[69]. (Picardo et al.,2010).

Foto 1.8 vitiligo inflamatore

- Blue vitiligo i referohet lezioneve ne ngjyre nuance blu qe vijne si rezultat pas nje vitiligoje inflamatore[69], (Picardo et al.,2010).

Foto 1.9 - Blu Vitiligo.

- Klasifikimi i vitiligos segmentale te fytyrës dhe qafes u propozua nga Gauthier në mënyrë për të përshkruar klinikisht kete nenlloj te vitiligos[25] (Gauthier Y. 2006).

Me poshte janë propozuar 5 lloje klinike në bazë të zonave qe inervojne nervat perkates:

Njolla te bardha rreth syrit qe inervihet nga nervi ophtalmic (V1), maxillar (V2) dhe mandibular (V3) pjese te deges trigeminale: Tipi I korrespondon V1 (Përfshirja e pjesshme ose të përgjithshme), Tipi II korrespondon V2 (Përfshirja e pjesshme ose të përgjithshme), Lloji III i korrespondon V3(Përfshirja e pjesshme ose të përgjithshme), Tipi IV eshte mix nga nervat e mesiperm dhe Tipi V korrespondon pjeses cervikofaciale te fytyrës[25] (Gauthier Y., 2006).

Foto 1.12



1.3- Prevalenca e vitiligos dhe paraqitja klinike

- Prevalenca

Vitiligo është çrregullimi më i zakonshmi dhe me I madh i depigmentimit që prek në rreth 0.5 %-2 % të popullsisë së botës . Megjithatë , është e vështirë për të vlerësuar dominimin e saktë të vitiligos . Ne Indi vitiligoja prek reth 8.8% . Kjo mund të jetë për shkak të përfshirjes së rasteve me vitiligo me shume, ne studimet e bera ne kete vend.

Nga ana tjetër, jane bere studime per te vlerësuar dominimin e vitiligos në popullsitë me ngjyre te zezë te lekures sic është studimi I bere ne brigjet perendimore te indise i cili rezultoi se prevalenca e vitiligo në popullaten me ngjyre të erret te lekures është e krahasueshme , ose pak më pak se , me të dhënat e gjetura aktualisht në popullaten me ngjyre të bardhë te lekures[10] . Në përgjithësi , normat më të larta te incidences jane regjistruar në Indi , e ndjekur nga Meksika dhe Japonia. Dallimi në mes të dhënave të prevalencës dhe incidencës mund të jetë për shkak të një raportimi më të lartë të vitiligos ne vendet, ku ngjyra e lekures eshte e erret dhe me nivel kulturor te larte dhe mund të detyrojë pacientët të kërkojnë konsultime të hershëm per lezionet e vitiligos te shfaqura ne lekuren e tyre dhe kjo eshte me dukshme ne popullaten me ngjyre te zeze te lekures[74] .

Gjinia

Të rriturit dhe fëmijët e të dy sekseve preken në mënyrë të barabartë nga vitiligo, edhe pse femrat paraqiten me shpesh për trajtime , kjo ndoshta për shkak të pasojave më të mëdha sociale tek gratë dhe vajzat e prekur nga kjo patologji[75,24] .

Mosha

Vitiligo prek të gjitha moshat, por zakonisht ndodh tek të rinjte mes moshës 10 dhe 30 vjec[75,24,15,37,74] . Megjithatë një tjeter studim epidemiologjik tregoi se pothuajse 50% e njerëzve qe zhvillojne vitiligo jane pas moshes 40 vjec[37] . Është vlerësuar se gati gjysma e pacientëve me vitiligo paraqiten para moshës 20 vjet per vizite, dhe gati 70-80% para moshës 30 vjec[74] . Një studim i kohëve të fundit sugjeroi se fillimi vitiligos ne femijeri (para moshës 12) prek 32% të pacientëve[56] , krahasuar me nje studim me te hershem qe raporton nje shifer 25% te pacienteve[30,38] . Po ashtu, i njëjti studim konfirmoi se shumica e pacientëve (89%) kishin histori per vitiligo para moshës 4 vjec[56] .

Vitiligo jo-segmentale mund të ndodhë në çdo moshë, ndërsa vitiligo segmentale ka tendencë të ndodhë në moshë të re[56] para moshës 30 vjec në 87% të rasteve, dhe para se të moshes e 10 vjec në 41.3%[56].

Së fundi, një studim në Jordani tregoi se prevalenca vitiligos rritet me moshën (0.45% <1 vjeç; 1% moshës 1-5 vjeç , 2.1% të moshës 5-12 vjeç)[4] .

Prezantimi klinik

Vitiligo klasifikohet ne vitiligo segmentale dhe vitiligo jo-segmentale.

Vitiligo jo-segmentale

Zonat e prekura më së shpeshti dhe ne fillim te patologjise se vitiligos jo-segmentale janë zakonisht ne fytyrë, e ndjekur nga trungu, qafa dhe pjesa e pasme trungut te trupit sipas Hann et al., 1997b)[33,34].

Është raportuar se vitiligo përgjithësisht mund të fillojë në çdo vend të trupit, por pjeset e lekures te ekspozuar në diell siç janë gishtat, duart dhe fytyra janë zakonisht zonat fillestare të raportuara nga pacientët[69] . Zonat interphalangeale, bërrylat dhe gjunjët janë sipërfaqet me te shpesh me te prekura nga siperfaqet extensore .

Ne pacientët me vitiligo në lekuren e duarve vitiligo shpesh përparon duke u shfaqur ne fytyre. Kjo shpjegon frekuencën e vitiligos acrofaciale me te madhe ne këta pacientë[33] .

Vitiligo segmentale

Në vitiligo segmentale zonat e zakonshme me te përfshira janë fytyra (51.1%), trungu i perparme (21.5%) dhe gjymtyrë (10.8%)[32] .

I njëjti studim tregoi se shpërndarja më e zakonshme dermatomale e vitiligos është sipas inervimit trigeminal 52.1%, , thorakal 22.8% dhe cervical 17.4% . Shpërndarja dermatomale trigeminale prek lëkurën e fytyrës. Shpërndarja dermatomale thoracale referohet lëkurës se trungut dhe shpërndarja dermatomale cervical prek lekuren kokes, qafes dhe extremitet e siperme.

Përfshirja e flokeve në vitiligo

Poliosis (depigmentimi e flokeve te kokës) (foto 1.4) është më e shpeshtë se ai

Manifestimi me I shpeshte I përfshirjes së zonave me qime në vitiligo ndjekur nga vetullat, flokët, regjionet pubike dhe axillar esipas një studimi te (Song, 1994)[76].

Foto 1.10 Poliosis.

- Perfshirja ne depigmentimin ngjyres se Syve dhe veshve në vitiligo.

Lezionet e hypopigmentuara në iris janë gjetur në 20-50% e pacientëve me vitiligo sipas disa studimeve. Megjithatë, nuk ka pasur prekje te syrit nga vitiliogo në një grup të vogël te raportuar ne paciente me ngjyre te zeze te vitiligos[3,2,9,12,71,6] .

Foto 1.11. Depigmentim I irisit te Syrit.



Humbje melanocyteve otice jane raportuar në disa raste te pacienteve me vitiligo. Jane raportura edhe crregullime të dëgjimit në paciente me vitiligo[20,57,61,82] .

Diagnoza diferenciale

Etiologjia e sëmundjes se vitiligos është ende e panjohur dhe prandaj përcaktimi dhe klasifikimi I saj janë thjesht përshkrues. Kur vitiligo është klasike, diagnoza mund te vendoset fillimisht në kujdesin parësor, por raste sfiduese kërkojnë vlerësim nga një dermatologu[28] .

Tabela 1.2 Diagnoza diferenciale për vitiligo jo-segmentale.

Patologjite qe përjashtohen nga përkufizimi e vitiligos jo-segmental		**Prezantimi Klinik**
Crregullime te trasheguara apo gjentike qe shfaqen me hypomelanosis	Peibaldism	Zona te depigmentuara ne vijen e mesme (midline) te trupit, ne pjesen frontale te kokes, dhe ne kurrizin e extremitetve te poshtme
Lezione te hypopigmentuara qe ne lindje apo te shfaqura me ekspozimet e para ne diell	Tuberus sclerosus	Ash-leaf njolla te bardha, angiofibroma, zhvillim I vonuar mendor
	Albinism	Diagnose diferenciale me vitiligo universal, merret parasysh klinike e fillimit e menjehershme apo progressive.
	Waanderburg's syndrome	Njolla te bardha ne pjesen frontale te kokes, shurdhim, crregullime ne pigmentimin e retines
Hypomelanosis post inflamatore	Psoriasis	Diagnoza behet duke u bazuar ne kliniken e ketyre patologjive.
	Eczema atopic	
	Lichen sclerosus	
Para-malignant hypomelanoses	**Mycosis Fungoides**	**Ne personat me ngjyre te erret te lekures t-cell lymphoma paraqietn me depigmentimem te lekures.**
	Melanoma qe paraqiten me	Karakterizohet nga

	depigmentim	depigmentime rreth melanomes ose me regresionit të melanomes primare.
Occupational disease, perdorimi I produkteve kimike	Vitiligo e shkaktuar nga perdorimi I lendeve kimike.	Shkaktohet nga perdorimi I lendeve kimike depigmentuese ex. Sic eshte fenolet ne industrine kimike.
	Depigmentim I shkaktuar nga medikamentet	Shkaktuar nga medikamnete të tilla si ne kohët e fundit Depigmentime te raportuar pas trajtim me imatinib, Imiquimod, kortikosteroidet fuqishëm lokalisht
Melasma	Crregullime te hyperpigmentimit	Zonat rreth melasmave gabimisht mund te merren per vitiligo.
Post traumatic leucoderma	Cikatrice post djegieve e thella te lekures apo traumatike	Lezionet mund te jene ne forme jo te zakonshme, sidomos kur trauma nuk mbahet mend nga pacienti.
	Toxic epidermal necrolisis	
Para-infectious hypopigmentation	Tinea versicolor	Mykozat e lekures qe shfaqin depigmentime me deskuamime
	Leprosis	Karakterizohet nga lezione hypochromic. Zakonisht te lidhura me humbjen e ndjeshmërisë dhe duhet të dyshuar në individë qe jetojnë në zonat endemike.

Tabela 1.3 Diagnoza diferenciale për Vitiligon Segmentale

Patologjite qe bejne diagnozen diferenciale me vitiligon segmentale

Prezantimi Klinik

Naevus depigmentosus	Nishane depigmentuese kongjenitale ose qe zbulohen në vitin e parë të jetës dhe ruajne te njejten në madhësi dhe përmasa gjate rritjes së fëmijëve.
Segmental or hemicorporeal hypomelanosis of Ito	Karakterizuar nga vija të ngushta depigmentura sipas Linjave Blascho qe mund të jetë e vështirë për të dalluar në rastet e vitiligos multisegmentale.

- Cilësia e jetës në pacientët me Vitiligo.

Porter et al raportuan se problemet kozmetike të kesaj sëmundje (në dukje të parëndësishëm) kane një ndikim të madh në cilësinë e jetës së ketyre pacientëve dhe ndikojne negativisht ne marrëdhëniet seksuale midis partnerve[70,65,77] . Shumë paciente ndihen keq psikologjikisht dhe te zënë ngushtë nga vitiligo. Ata përjetojnë diskriminim nga të tjerët dhe besojnë se ata nuk e marrin mbështetjen dhe mjekimin e duhur nga mjekët e tyre[70,77] .

Një studim i fundit i kryer nga Britania e Madhe tregoi se mbi gjysma (56.6%) e anketuarit treguan se vitiligo e moderuar ose e rëndë ndikonte ne kualitetin e jetes se tyre. Gjetja e një kurë efektive ose të qëndrueshme ishte prioriteti kryesore për të anketuarit prekur nga vitiligo. Negative ishte pergjigja se ku e gjenin keta pacient informacionin mbi patologjine e tyre, ata theksuan se Informacion e merrnin nga burime te tilla si : nga shoqëria e tyre jo me informim mjekesor (kjo ne shumicen e rasteve), nga interneti, dhe nje pjese nga dermatologu[81] .

Gjithashtu, pacientët me vitiligo marrin nje mbeshteteje të kufizuara ose ambivalent nga miqtë dhe familjet e tyre, dhe të përjetojnë një numer te problemeve psikologjike të tilla si turp, depresioni dhe ankthi, të cilat mund të çojë në vetëvleresim të ulët për veten dhe izolim social[70]. Shumica e pacientëve me vitiligo në zonat e ekspozuar ankohen per pranine e ndjenjave të pakëndshme në krahasim(ne shumicen e rasteve), në krahasim me ata me lezione në zonat paexposuara[59] . Emocionet e cituara më shpesh ishin frika, veçanërisht nga përhapja e lezioneve vitiliginous (71%), turp (57%), pasiguria (55%), trishtim (55%).

Vetë-vleresimi i pacientëve me Vitiligo është gjithashtu i ulur në mënyrë të konsiderueshme. Crregullimet emocionale si ne humor janë të zakonisht te ulura, veçanërisht në adoleshentët. Vitiligo që fillon në fëmijëri mund të të shoqërohet me trauma të rëndësishme psikologjike që mund të të ketë një efekt të gjatë të qëndrueshme në vetë-vleresimin personal te fëmijës me

vitiligo. Zakonisht ata shmangin ose kufizojne aktivitetet sportive dhe shpesh humbasin ditë vitale në shkollë[65,67] .

Një studim në Hollande mbi ndikimin e vitiligos ne fëmijëri dhe në jetën e të rriturve treguan se zhvillimi psikoseksual i të rriturve të rinj me vitiligo gjate fëmijërisë eshte I ulur. Megjithatë, pacientët raportuan ndjenja negative nga prania e vitiligos gjatë fëmijërisë në mënyrë të konsiderueshme dhe kjo sillte shumë probleme në zhvillimin social te tyre[47] .

Përveç kësaj, një studim i bere ne pacientët muslimanë femra me vitiligo në Iran tregoi se ato përjetojnë nje cilësi më të madhe të jetes se se meshkujt[65,67] , kjo ndoshta per shkak te mbulimit dhe mos ekspozimit te zonave me vitiligo.

Aktualisht, nuk ka hulumtime të sakta te bera mbi ndikimin psikologjik te sëmundjes dhe efikasiteti I terapise psikologjike për pacientët[69,63].

Ne nje studim te bere nga Papadhopulos et al (1999)[63] eshte pare se terapia psikologjike mbi ndryshimin e sjelljes dhe suportimin psikologjik te vitiligos mund të sigurojë dobi në aspektin e përballimit te jeteses në personat me vitiligo dhe kjo terapi psikologjike vetë mund të ketë një efekt pozitiv në progresionin e sëmundjes.

1.4- **Etiologjia dhe patogjeneza e vitiligos**

Etiologjia e vitiligos nuk është akoma e qarte sa duhet dhe ka qenë të burim diskutimesh dhe studimesh për dekada të tëra. Ende nuk është e qartë nëse melanocitet në lezionet vitiligos janë zhdukur apo kane dale thjesht jashte funksionit te tyre qe eshte prodhimi I melanines pigmentit qe I jep ngjyre lekures

Figura 1.9.. Melanocitet dhe humbja e funksionit te tyre ne prodhimin e melanines.



Shkaku i shkatërrimit melanociteve është i panjohur. Supozohet se vitiligo eshte nje semundje multifaktoriale.

Figura 1.9.2. Mekanizmat multifaktorial ne etiologjine e vitiligos.



Jane bere studime te cilat kane treguar lidhjen e vitiligos me patologji si me çrregullime autoimune te gjendres tiroide[73,21,8] , ku vitiligo ka qene e bashkeshoqeruar me keto patologji.

Jane ngritur per studim tre hipoteza te vecanta ajo,

1- Autoimune

2-Nervore

3-Vetëshkatërrimit te melanociteve.

Jane zhvilluar edhe disa teori te tjera për të shpjeguar patogjenezën e kesaj sëmundje te propozuar multifaktoriale[17,19,43,72,79] .

Teoria imunologjike dhe teoria gjenetike duken si me te saktat për vitiligon deri më sot.

- Hipoteza autoimmune dhe gjenetike.

Hipoteza e autoimunitetit bazohet ne reagimin antigjen-antitrup, i cili shkakton mosfunksionim melanociteve dhe të çon në vitiligo. Dy mekanizma imun janë propozuar[86] (Ortonne et al., 1983). Një mekanizëm që përfshin një çrregullimi primar në sistemin imunitar qe rezulton në autoimmunisation me formimi i autoantibodies kundër melanocyte si antigjene. Si pasojë, melanocitet shkaterrohen dhe frenohet prodhimi I pigmentit melnine melanina

Mekanizmi i dytë është përqëndruar në demtimin e melanociteve I cili shkakton atyre për clirimin një substancë antigjenike e cila ndihmon për të gjeneruar antitrupa, duke frenuar melanogjenezen dhe duke çuar ne zhdukjen e melanocyteve.

Etiologjia autoimune e vitiligos konsiderohet si me e sakta deri me sot duke u bazuar edhe ne faktin e bashkeshoqerimit te ketij crregullimi me çrregullime të tjera autoimune sic eshte thyroiditis autoimun, semundja Addison, myasthenia gravis, anemia pernicioze, diabeti mellitus, morphoea, hypoparathyroidism dhe halo Zoster[28] .

Figura 1.9.3. Hipoteza autoimune.



Gjithashtu, studimet kanë treguar se frekuenca e vitiligos dhe sëmundjeve të tjera autoimune është rritur në të afërmit e pacientëve me vitiligo, mbështetur kjo ne komponentin gjenetik për vitiligo.

- Hipoteza neurogjenike

Sipas teorisë neurogjenike, humbja e një efektit normal te neurohormoneve dhe neuropeptideve mund te shkaktojë humbjen apo demtimin e melanociteve dhe si rezultat vitiligon segmentale[1,52,14],

Dhe së fundi, shpërndarja e depigmentimit në Vitiligon segmentale eshte e ngjashme me ate të shpërndarjes dermatomale te herpes zoster madje eshtë propozuar që vitiligo segmental mund të rezultojë nga mosfunksionimi i inervimit simpatik në zonen e prekur[41,40] .

Figura 1.9.4 Hipoteza neurogjenike.



- **<u>Hipoteza e vetshkaterrimet te melanociteve</u>**

Kjo hipotezë bazohet në ate qe një metabolite sic jane fenolet I prodhuar gjate sintezës se melaninës çon në zhdukjen e melanocytes. Fenolet dhe derivatet e saj mund të shkatërrojë melanocytes [87]. Gjithashtu grumbullimi i Dderivateve toksike apo produktev si (tyrosine, triptofan, DAP, dopachrome, dhe 5,6 dihydroxyindole) gjatë sintezës së melaninës shkaktojne vdekjen e melanocyte[88].

Teori të tjera të tilla si teoria e stresit oksidativ, teoria e fenomenit Koebner-së, teoria e citokineve gjithashtu supozohen per etilogjine e vitiligos.

<u>-Teoria e stresit oksidativ.</u>

Sipas teorisë stresit oksidativ, ajo sugjeron se degjenerimi melanocitar shkaktohet nga prodhimi I radikalet e lira dhe toksinave dhe metabolitëve toksik të tjere të prodhuara brenda ose jashtë qelizës gjate metabolizmit qelizor , te cilat cojne ne demtimin e funksionit apo shkaterrimin e melanociteve ne lekuren me vitiligo, për shkak të një defekti ne rrugen e antioxidimit[10,39,44,79,80] .

Figura 1.9.5 Teoria e stresit oksidativ.

Gjithashtu, melanocitet ne kultura in vitro tregojnë rënie te niveleve e Catalases, enzimë kjo që përfshihet në eleminimin e radikaleve te peroksidit te oksigjenit te gjeneruar nga metabolizmi qelizor dhe rrezatimi UV[18,39,42,51] .

- **Teoria fenomenit Koebner.**

Lezione te vitiligos janë përshkruar në vendet e traumave të përsëritura të tilla si fërkime të përsëritura ose presion ta vazhdueshem, ne cikatricet apo njollat e hypopigmentura te lena nga sherimi I plageve apo djegieve,[22,26,25] .

Fenomeni i Koebner, i quajtur sipas dermatologut gjerman Koebner në vitin 1877, i referohet shfaqjes se lezioneve te reja psoriatike pas traumave te siperpermendura ne personat me psoriasis.[36,45,54,78].

Më vonë në 1890, Kaposi ishte i pari qe beri lidhjen e fenomenit te Koebner me shfaqja e lezioneve të reja Vitiligos ne personat me apo pa vitiligo[69].

Si pasojë, u hodh hipoteza që shumë lezione të vitiligos jo-segmentale mund të lidhen me fërkime të përsëritura qe ndodhin gjatë larjes, veshjes, kujdesit personal, aktiviteteve sportive apo aktivitete të tjera fizike[22,26,].



Figura 1.9.5 Fenomenin Koebner-së[79] (Taieb dhe Picardo, 2009).

Në fenomenin Koebner, njollat e vitiligos zhvillohen si rezulat I një përgjigje isomorfike fërkimi apo presionit që rezulton nga aktivitetet e tilla të zakonshme si larja e flokëve, tharja e lëkurës me një peshqir, etj.

Bazuar në fenomenin e Koebner, ose sic quhet ndryshe Koebnerisation qe mund të ndodhë në vendin e lekures gjate grafts transplant kjo është nje arsye e rëndësishme për të vlerësuar rrezikun i krijimit te lezione të reja te vitilgos pas procedurave kirurgjike ose kozmetike në pacientët me Vitiligo[36,53].

<u>- Teoria e veprimit te citokinave</u>

Gjithashtu, studimet kanë treguar se njesite e epidermike njerëzore te melanines njerezore përfaqësojne nje lidhje symbiotice në të cilën nga një qelize melanocitike transportohet pigmenti I melanines nëpërmjet dendriteve të saj në rreth 36 keranocite,[24,23].

Për më tepër, të dhënat sugjerojnë se melanogjenesis rregullohet me anë të clirimit citokinave specifike melanogjenike te prodhuara dhe te lëshuara nga keratinocytet dhe nga faktorët e rritjes te derivuar nga fibroblastet te cilat mund të të kontribuojnë në rregullimin e aktiviteteve melanocytike dhe pigmentimit te lekures . Së fundi, vitiligo ne lekure , vjen si rezultat I humbjes se aftesise se keratinociteve per te prodhuar citokina dhe uljes se prodhimit te faktoreve te rritjes nga fibroblastet te cilat ndikojne direkt ne aktivitetin e melanociteve per te prodhuar melanin. Një çekuilibër i tillë ndoshta luan një rol në zhdukjen e melanocyteve nga mos aktivizimi I tyre nga cytokinat dhe faktoret e rritjes[13,60,83] .

Në përfundim, teori të ndryshme janë sugjeruar për të shpjeguar patogjenezën e vitiligos te cilat te gjitha së bashku, tregojnë se vitiligo është nje patologji multifaktoriale dhe mund të jetë me

teper një Sindrome se sa një sëmundje të vetme[85,44] sepse asnjë teori e vetme nuk e shpjegon plotësisht fizpatologjine e vitiligos[69] .

- **Histopatologjia**

Diagnoza e vitiligo mund të bëhet klinikisht, megjithatë në raste të vështira, jane marre edhe biopsi të lëkurës per te diferencuar vitiligon nga çrregullime të tjera të pigmenteve ne lekure[69].

Gjate egzaminimit histopatologjike në lëkurën vitiliginoze është pare si karakteristike mungesa e melanociteve në shtresen bazale te lezionit te marre dhe humbja e pigmentit melaninë ne keratinocite e shtreses keratotike te epidermes, ne keto raste numri i reduktuar i melanociteve vjen si rezultat i ndryshimeve degjenerative të pranishëm në lezionet vitiliginoze [34].Gjate egzaminimit histopatologjike te lezioneve vitiliginoze eshte e rendesishme te vleresohet nese semundja eshte active apo e qendrueshme duke e krahasuar me lekuren normale[69]. Gjetjet histopatologjike ndryshojnë në bazë të 3 fazave qe kalon kjo patologji. Faza e hershme e semundjes, faza aktive e semundjes dhe faza e qendrueshme e saj per nje kohe te gjate[34]. Në lezionet gjate fazës të hershme, shihet procese inflamatore, infiltrate limfocitare në lezionin vitiligonoz. Procesi inflamator zakonisht eshte process inflamator lichenoid me ndryshime te vogla ne shtresen e epidermes. Gjithashtu gjate kesaj faze shihet prania e disa melanocyteve dhe Melaninës në shtresën bazale te epidermes[85,69].Ne Fazen e aktive dhe ate te qendrueshme te semundjes ne lezionet vitiliginoze shihet mungesa e pigmentit melaninë në shtresen e epidermes ndryshe nga ajo normale.



Foto 1.10.1 Vitiligo segmentale (b) grumbullime lymfocitare reth melanociteve ne shtresen bazale te epidermes dhe humbje pigmenti (grade L1) (H and E, ×40).

Përveç kësaj, në lezionet gjate fazes se qendrueshme te vitiligos, jane pare ndryshime degjenerative në nervat qe inervojne ate zone te lekures dhe strukturat adnexale te saj (të tilla si flokët, muskujt e lëkurës dhe gjëndra).

Si përfundim, ndryshimet e histopatologjike i referohen vetëm vitiligos jo-segmentale, sepse per vitiligon segmenatel te dhenat nga studime histopatologjikesi jane te pamjaftueshme për të arritur një përfundim[5]. . Prandaj te dhenat në histopatologjinë e fazës se hershme te lezione jo-segmentale dhe segmental vitiligos ndoshta do të kontribuojnë në te ardhmen per të kuptuar etiologjine e vitiligos.

Vleresimi dhe ecuria e vitiligos

Pavarësisht nga fakti se shumica e studimeve masin nepermjet sistemit te pikezimit perqindjen e ripigmentimit nuk ka dy studime qe te kene perdorur saktësisht të njëjtën metodë për të shënuar rezultatet.

Tabela 1.9 Lista e vleresimit te perhapjes se vitiligos jo-segmentale

Vecorite e pacientit	**Vecorit e semundjes**	**Historia familjare**	**Ndjekja nderhyrja** Interventions
Phototype (Fitzpatrick's skin type) **Origjina etnike** **Mosha** **Angazhimi professional** **Niveli I stresit dhe ankthit** **Halo nevus** **Histori per semndje autoimmune**	Kohëzgjatje Aktivitetit, (Progresive, regresive, e qëndrueshme ne 12 muajt e fundit Episode të Ripigmentimit Koebner-së fenomen prurit perapa sheperthimit te semundjes psemundje te gjendres tiroide	Floke te thinjur te parakohshëm Histori familjare per Vitiligo Sëmundje autoimune në familje	Lloji dhe kohëzgjatja e trajtimeve te perdorura duke përfshirë opinionin nëse kane qene efektive / dhe te dobishme. Sëmundje të tjera

Global Quality of life. Assessment, si semundja ndikon ne jeten tuaj te perditshme (10-point analogue scale)	Vitiligo në organet gjenitale Fotografi te pamjes klinike		

Vlerësimi i propozuar i fazës së sëmundjes është bazuar në modelin e repigmentimit si vijon:

 Faza 0 - pigmentim normal

 Faza 1 - depigmentim jo I plote

 Faza 2 – depigmentim I plotë qe perfshin edhe depigmentimin e flokeve ne më pak se 30%.

 Faza 3 – depigmentim I plotë qe perfshin edhe depigmentimin e flokeve ne më shume se 30%.

-Së fundi, përhapja e sëmundjes është vlerësuar si:

 0 - sëmundje e qëndrueshme (vitiligo stable)

 -1 - vërehet në vazhdim repigmentim I vitiligos

 +1 – verehet ne vazhdim depigmentim shtese ne zona te tjera te lekures.

Ne vazhdim, the Vitiligo European Task Force rekomandon se ne mënyrë për të testuar dhe vlerësuar vitiligon eshte e nevojshme edhe marrja parasysh I opinionit te vete pacienteve qer vuajne nga semundje per te vleresuar ecurine e saj[80].

Gjithashtu, duke qene se vitiligo eshte një sëmundje psikologjike shkatërruese (shih Cilësia e jetës në pacientët vitiligo), përfshirja e një pyetësor i detajuar , për të vlerësuar plotësisht peshën dhe ndikimi psikologjik i sëmundjes , në standarde klinike do të jetë mjaft I dobishem [69] .

Së fundi, indeksi i repigmentimit i propozuar kohët e fundit nga Benzekri et al., 2012[7], ku të gjitha lezionet vitiliginose në një pacient të caktuar janë shqyrtuar dhe klasifikuar sipas klasifikimit te mëposhtme:

Lloji A- lezione hypochromic

Lloji B- lezione achromic me qime të errëta dhe

Ljoji C- lezione achromic me qime të bardha.

2. Qellimi dhe objektivat e studimit.

Vitiligo eshte nje patologji e lekures qe karakterizohet nga zona te depigmentuara te saj, eshte nje crregullim i fituar dhe progresiv ne te cilin disa ose te gjitha melanocitet shkaterrohen dhe mendohet te jete nje proces autoimun. Ne bote vitiligo kap rreth 2 % te popullsise , ne vendin tone nuk ka te dhena se cfare perqindje e popullsise vuan nga ky demtim, cilat jane shkaqet , lidhja e saj me procese te tjera autoimune, impakti qe ka ne cilesine jetes kjo semundje e lekures tek personat e prekur, lidhja saj me moshen, gjinin apo dhe trashegimin. Studimi i thelluar i ketij problemi do te ndihmonte ne nxjerrjen e te dhenave te sakta per sa i perket perhapjes se vitiligos, identifikimin sa me te hershem te kesaj patologjie dhe menaxhimin sa me te shpejt te saj si nje prej crregullimve depigmentuese me impakt negativ ne cilesin e jetes se individeve te prekur.

2.1 Qellimi i studimit.

Qellimi I ketij studimi eshte pasqyrimi i plote i prirjeve epidemiologjike, faktoreve te riskut, tipareve klinike dhe efikasitetit te nderhyrjeve sa me te shpejta parandaluese dhe trajtuese te Vitiligos ne Shqiperi.

Pershkrimi i perhapjes se Vitiligos ne vendin tone . Detajimi i faktoreve te riskut . Format e ndryshme klinike dhe pasojat me te shpeshta te semundjes ne jeten sociale e individit. Rezultatet e trajtimit te rasteve te thjeshta dhe te nderlikuara. Efikasiteti i masave parandaluese ne vendin tone.

Ky studim përfshin si vijon:
-Studimi i thelluar i ketij problemi do te jepte te dhena te sakta per epidemiologjine e kesaj patologjie ne Shqiperi, do te ndihmonte ne nderhyrje me efikase per te parandaluar dhe menaxhuar rastet, dhe lidhjen e saj me patologji te tjera.

- Ky studim i kryer me raste te konfirmuara do te zgjeroje bazen e informacioneve te deritanishme per rastet me vitiligo ne vendin tone ,duke lene nje punim i cili sherben si reference per punime te tjera pasardhese .

Qëllimi i studimit mbi Vitiligon është të vlerësojë prevalencën e Vitiligos në popullatën shqiptare si dhe të mbledhë informacion të mjaftueshëm mbi cilësinë e jetës në subjektet me Vitiligo. Ky informacion do të jetë një ndihmesë e madhe për mjekët dermatologë në diagnostikimin si dhe vlerësimin e cilësisë së jetës për të parë mundesitë e ndërhyrjeve dhe politikave që kanë si synim jo vetëm përmirësimin e cilësisë së jetës por dhe integrimin e tyre në shoqëri.

Objektivi i përgjithshëm i studimit:

- Përcaktimi i prevalencës së Vitiligos në popullatën shqiptare.
- Përcaktimi i perceptimit të cilësisë së jetës në subjektet e prekur nga Vitiligo

2.2. Objektiva specifike te studimit.

- Përshkrimi i subjekteve të marra në studim sipas grupmoshës dhe gjinisë.
- Përshkrimi I subjekteve të marra në studim sipas karakteristikave socio-demografike (niveli i arsimimit, vendbanimi dhe statusi civil).
- Përshkrimi i subjekteve të marra në studim sipas stilit të jetesës (duhanpirja, alkooli)
- Përshkrimi i subjekteve të marra në studim sipas karakteristikave të sëmundjes (mosha e shfaqjes, kohëzgjatjes së sëmundjes, dekursit natyral të Vitiligo, llojit të Vitiligos, sëmundjeve shoqëruese, pranisë së Pruritit dhe fenomenit Köbner).
- Përshkrimi i subjekteve të marra në studim sipas pjesëve të trupit të prekur nga Vitiligo.
- Përshkrimi i subjekteve të marra në studim sipas perceptimit të cilësisë së jetës.
- Përcaktimi i lidhjes qe ekziston midis faktorëve socio-demografike dhe pjesëve të trupit të prekura nga Vitiligo me perceptimin e cilësisë së jetës nga ana e subjekteve të marra ne studim.

3. Metodologjia.

Ky ishte nje studim I tipit transversal qe u zhvillua ne Spitalin Ushtarak Tirane dhe Polikliniken Nr 9 Tirane per periudhen kohore 2013-2014 me synim vleresimin e prevalences dhe faktoreve percaktues te vitiligos.

3.1 Përzgjedhja e subjekteve në studim.

Për realizimin e studimit është përdorur zgjedhja e subjekteve me shtresëzim duke marrë parasysh rezultatet e censusit dhe shpërndarjen e pupullsisë shqiptare sipas gjinisë dhe grupmoshës.

Arsyetimi I mëposhtëm jep te qartë mënyrën e kampionimit të popullatës së marrë në studim. Filimisht është parë shpërndarja e popullsisë shqiptare sipas grupmoshës dhe gjinisë referuar censusit te vitit 2011[7]. Bazuar në prevalencën e pritshme te Vitiligos të dhënë nga Krüger C, Schallreuter[3], rezulton se kjo prevalencë është ne shifrat 0.1-2%. Nga kjo prevalence e

pritshme u llogarit që numri I popullatës që do merrej në studim për gjetjen e prevalencës së Vitiligos në vendin tone rezultoi 1758. Mostra totale prej 1758 është llogaritur në mënyrë të tillë për të kapur një prevalence të përafërt me atë të raportuar nga autorë të huaj, me një nivel sinjifikance $p \leq 0.05$. Kjo popullatë është përzgjedhur sipas metodës së kampionimit me shtresa bazuar në shpërndarjen e popullsisë në numër absolut dhe përqindje për cdo kategori grupmoshë-gjini.

Më pas, është realizuar përshtatja e grupmoshave në mënyrë që të përqasej me studimin tone:

- Duke patur parasysh se shkalla e sëmundshmërisë nga Vitiligo në mosha të vogla është e ulët, është realizuar zgjerimi I intervalit të grupmoshës pediatrike në 0-15 vjeç.

- Duke patur parasysh që Vitiligo është një sëmundje jo shumë prevalente në individët mbi moshën 74 vjeç, kjo grupmoshë është përjashtuar, pasi nuk përbën interes për studimin tonë.

Më pas, nga numrat absolute të popullsisë rezidente shqiptare janë nxjerrë proporcionet e çdo kategorie grupmoshe dhe gjinie, duke patur parasysh që si 100% është marrë totali I femrave më vete dhe I meshkujve më vete. Bazuar në numrat absolute të popullsisë është ndërtuar piramida grupmoshë-gjini për popullsinë shqiptare referuar censusit të vitit 2011.

Tabela 1 Shpërndarja e popullsisë shqiptare sipas Censusit të vitit 2011

Censusi 2011						
Grupmosha	Meshkuj	Femra	Totali	Meshkuj (%)	Femra(%)	Totali (%)
0-14	301,711	276,855	578,566	22.4	20.8	21.6
15-24	263,922	248,469	512,391	19.6	18.7	19.1
